



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 82 , Datë 04.05.2020

“MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “POWERCOMM”
SH.P.K, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma d) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma e), nenit 5, pika 1, gërma e), nenit 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 i ndryshuar, dhe nenit 19, pika 1, gërma a) të Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 04. 05.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licensimit, Mbikëqyrjes dhe Autorizimeve, lidhur me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “PowerComm” Sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “PowerComm” Sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr.662, datë 24.04.2020, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “PowerComm” Sh.p.k., me aplikimin për pajisjen me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, rezulton si më poshtë:
- Format i dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gërmat a), b), c). **Plotësuar**

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gërmat a), b), c), e). **Plotësuar**
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gërmat a), b), c), d). **Plotësuar**
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.8, pikat a), b), c). **Plotësuar**
- Për dokumentacionin e munguar, si kërkesë e nenit 9, pika 2, gërma d) të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”* do të njoftohet aplikuesi për plotësimin e tij, brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e Shoqërisë “PowerComm” Sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI